

VENDIM
Nr. 865, datë 27.12.2022

**PËR KUSHTET, KRITERET DHE PROCEDURAT E PËRFITIMIT, TË
POSEDUESVE TË NDËRTIMEVE PA LEJE NË RASTET E FATKEQËSISË
NATYRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 30, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim rregullon kushtet, kriteret dhe procedurat e përfitimit, të individëve dhe familjeve, të cilët posedojnë ndërtime pa leje me funksion banimi, që pësojnë dëme, për shkak të fatkeqësive natyrore.

2. Në këtë vendim, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) “Ligji”, ligji nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”;

b) “Përfitues”, subjekti posedues i një ndërtimi pa leje me funksion banimi, që rezulton i dëmtuar pas një fatkeqësie natyrore, në një njësi të vetëqeverisjes vendore, ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore;

c) “Ndërtim pa leje”, ndërtimi i lidhur në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme me tokën ose me ndërtesa të tjera, i cili është bërë pas datës 10.8.1991, me funksion banimi, i cili paraqitet si objekt, si shtesë në ndërtim të regjistruar/në mungesë të lejes së ndërtimit ose si objekt në shkelje të lejes së ndërtimit;

ç) “Organ përgjegjës/njësi zbatuese”, njësia e vetëqeverisjes vendore ose organi publik i ngarkuar nga Këshilli i Ministrave, përgjegjës për rindërtimin dhe/ose mbrojtjen civile.

**II. KUSHTET, KRITERET DHE PROCEDURAT E TRAJTIMIT TË NDËRTIMEVE
PA LEJE NË RASTET E FATKEQËSISË NATYRORE**

1. Për të përfituar nga trajtimi në rastet e fatkeqësisë natyrore duhet të plotësohen kushtet dhe kriteret e mëposhtme:

a) Ndërtimi pa leje të rezultojë i dëmtuar pas një fatkeqësie natyrore në një njësi të vetëqeverisjes vendore, ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore;

b) Ndërtimi pa leje të jetë përfshirë në procedurat e legalizimit dhe për të, të mos ketë përfunduar procesi administrativ me vendimmarrje për legalizim;

c) Ndërtimi pa leje të rezultojë me funksion banimi, gjatë evidentimit në terren që kryen ASHK, sipas ligjit;

ç) Individit ose familja të mos ketë ndërtim tjetër në pronësi apo më shumë se një ndërtim pa leje me funksion banimi në proces legalizimi, në njësinë e vetëqeverisjes vendore ku shpallet gjendja e fatkeqësisë natyrore. Kur individit apo familja ka disa ndërtime në pronësi apo në proces legalizimi dhe të gjitha ato dëmtohen si pasojë e fatkeqësisë natyrore, atëherë përfiton vetëm për banesën, që në datën e fatkeqësisë natyrore, përdorej si vendbanim i zakonshëm;

d) Ndërtimi pa leje plotëson kushtet e ndërtesës së dëmtuar, sipas pikës 12, të nenit 4, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të vërtetuar në bazë të aktekspertizës të organeve kompetente, sipas këtij akti normativ.

2. Procedura e përjashtimit nga legalizimi të ndërtimeve pa leje që dëmtohen nga fatkeqësia natyrore nis me kërkesën e organit përgjegjës/njësisë zbatuese drejtuar ASHK-së.

3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga paraqitja e kërkesës nga organi përgjegjës/njësia zbatuese, drejtoria vendore e ASHK-së evidenton në terren ndërtimet pa leje dhe verifikon, nëse për to është paraqitur kërkesë për legalizim. Kur rezulton se është paraqitur kërkesë, brenda të njëjtit afat, kryhet dhe procedura e përjashtimit nga legalizimi.

4. Vendimmarrja e përjashtimit, sipas pikës 3, të këtij kreu, i përcillet organit përgjegjës/njesisë zbatuese dhe shoqërohet nga:

- a) dokumentacioni hartografik (genplan dhe planimetri);
- b) ekstrakti nga baza e të dhënave;
- c) informacion kadastral;
- ç) të dhëna nëse përfituesi zotëron apo jo banesë tjetër të ligjshme, brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Kjo vendimmarrje i njoftohet, njëkohësisht, dhe subjektit posedues të ndërtimit pa leje, sipas mënyrës dhe afateve të parashikuara në ligj dhe në Kodin e Procedurave Administrative.

5. Mënyra e trajtimit dhe kriteret për përfitimin e sipërfaqeve ndërtimore të subjekteve përfitues, sipas këtij vendimi, është sipas parashikimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave, për kushtet dhe kriteret e përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje, miratuar në zbatim të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”.

6. Ngarkohen Agjencia Shtetërore e Kadastrës, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe organet publike që preken nga ky vendim, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama